

UDHËZIM
Nr. 4, datë 19.3.2012

**PËR ORGANIZIMIN E KURSIT TË TRAJNIMIT PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË SHPEJTË
MJEKËSORE NË RAST AKSIDENTI RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 119, 120 dhe nenit 121 pika 6 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Ministri i Shëndetësisë

UDHËZOJNË:

Neni 1

Kursi i trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor bëhet nga Kryqi i Kuq Shqiptar nëpërmjet degëve përkatëse bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky kurs i organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ka për qëllim përgatitjen e personave të interesuar për pajisje me leje drejtimi të mjetit rrugor me njohuritë e nevojshme për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore, duke parandaluar dhe zvogëluar pasojat në rast aksidenti rrugor.

Neni 2

Personi i interesuar për pajisje për herë të parë me leje drejtimi të mjetit rrugor duhet të regjistrohet pranë Kryqit të Kuq Shqiptar, degëve përkatëse, gjatë periudhës së kryerjes së programit teorik në autoshkolla.

Neni 3

1. Kryqi i Kuq Shqiptar kryen kursin e trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor sipas programit mësimor teorik dhe praktik të miratuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Ministria e Shëndetësisë, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Programi i kursit të trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor përgatitet dhe përditësohet në përputhje me normat dhe standardet europiane dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë rrugore. Ky program është pjesë integrale e strategjisë kombëtare të sigurisë rrugore 2011-2020 dhe planit të veprimit për sigurinë rrugore 2011-2015, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 23.2.2011 “Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore”.

2. Tarifa për çdo person që kryen kursin e trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor është 1500 (një mijë e pesëqind) lekë duke përfshirë dhe TVSH-në.

3% e kësaj tarife derdhet në buxhetin e MPPT-së nga Kryqi i Kuq Shqiptar çdo 6 muaj dhe përdoret për përmirësimin e sigurisë rrugore.

3. Kryqi i Kuq Shqiptar pajis me dëshmi në përfundim të kursit të trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor çdo person, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kryqi i Kuq Shqiptar plotëson regjistrin e Kursit të Trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor në mënyrë elektronike sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe ia dërgon atë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Neni 4

1. Personi i interesuar për të hyrë në prova për leje drejtimi të mjetit rrugor, në zbatim të nenit 119 të Kodit Rrugor, paraqet nëpërmjet drejtuesit teknik të autoshkollës, në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, dëshminë e kursit të trajnimit për dhënie e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast

aksidenti rrugor, së bashku me dokumentet e përcaktuara për marrjen në provën e njohurive teorike.

2. Sektori përkatës i DRSHTRR-së, pasi verifikon dëshminë e kursit të trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor, plotëson dokumentet e personit të interesuar për të hyrë në prova për lejedrejtimi të mjetit rrugor me fotokopjen e nënshkruar nga punonjësi i pranimi.

3. Komisioni i kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi të mjetit rrugor, realizon provën e testimit vetëm për personat e interesuar të cilët në dokumentet e paraqitura është e fotokopja e nënshkruar e dëshmisë së kursit të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar.

Neni 5

1. Dëshmia e kursit të trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor është e vlefshme për drejtuesit e mjeteve rrugore që kërkojnë të marrin kategori më të lartë lejedrejtimi dhe plotësimi i dokumentacionit bëhet si në nenin 4 pika 2.

2. Personi i interesuar për të hyrë në prova për lejedrejtimi të mjetit rrugor, i cili ka kryer studimet e larta në degët mjekësi apo infermieri, nuk e kryen kursin e trajnimit për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti rrugor.

Personi i interesuar për të hyrë në prova për leje drejtimi, dorëzon fotokopjen e diplomës të nënshkruar nga urdhrat përkatës (urdhri i mjekut dhe urdhri i infermierit), dhe administrohet nga punonjësi përkatës i sektorit të DPSHTRR-së.

Neni 6

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Kryqi i Kuq Shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ndërsa për monitorimin e tij Sekretaria Teknike e Komitetit Ndërmintor të Sigurisë Rrugore dhe Drejtoria e Planifikimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë.

Neni 7

Udhëzimi nr. 1968, datë 28.4.2005 “Për organizimin e kursit të ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti”, udhëzimi nr. 3846, datë 29.8.2005 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1968, datë 28.4.2005 “Për organizimin e kursit të ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti” dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me këtë udhëzim shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT

Sokol Olldashi

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Petrit Vasili